

E DREJTA NOTERIALE

| | |
|----------------------------------|---|
| Të dhëna bazike të lëndës | |
| Njësia akademike: | Fakulteti Juridik |
| Titulli i lëndës: | E drejta noteriale |
| Niveli: | Master (LL.M.) në të drejtën civile dhe pronësore |
| Statusi lëndës: | Zgjedhore |
| Viti i studimeve: | I |
| Semestri: | II |
| Numri i orëve në javë: | 3+0 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 3 |
| Koha / lokacioni: | |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof.ass.dr. Bashkim Preteni |
| Detajet kontaktuese: | bashkim.preteni@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës | <p>Lënda “E drejta noteriale” është një degë e rëndësishme e së drejtës, e cila rregullon marrëdhëniet juridike nga fusha të ndryshme të drejtësisë siç janë marrëdhëniet pronësore, marrëdhëniet detyrimore, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet trashigimore, etj. Kjo lëndë analizon atributet kryesore të noterit dhe veprimtarisë noteriale siç janë: ushtrimi i veprimtarisë noteriale, autorizimet noteriale të noterit, ndarja e dokumenteve noteriale, përmbajtja dhe procedura e përpilimit të dokumenteve noteriale, njohja, zbatimi dhe përmbarueshmëria e dokumenteve noteriale, etj. Kjo lëndë ofron një shqyrtim të thelluar të këtyre rregullave noteriale. Përmes një qasjeje teorike dhe praktike, studentët do të shqyrtojnë parimet bazë të funksionimit të sistemit noterial dhe domosdoshmërinë për krijimin e efikasitetit të të bërit biznes. Gjithashtu, kjo lëndë përfshinë edhe një analizë krahasuese ndërmjet legjislacionit vendor, të drejtës krahasuese dhe rregullave ndërkombëtare në fushën e noterisë, duke përfshirë edhe përafrimin me praktikën më të mira noteriale evropiane dhe unifikimin e procedurave ndërkufitare.</p> |
| Qëllimet e lëndës: | <p>Qëllimet e lëndës janë që studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë parimet themelore të së drejtës noteriale dhe rolin e saj në sistemin juridik; - Identifikojnë dhe analizojnë procedurën dhe përmbajtjen e noterizimit, duke përfshirë kontratat, autorizimet e ndryshme, testamentet dhe aktvendimet noteriale, vërtetimet dhe deklaratat e ndryshme dhe solemnizimin noterial; - Zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike në interpretimin e dispozitave ligjore noteriale, |

| | |
|--|---|
| | <p>klauzolare kontraktuale dhe zbatimin e tyre në praktikë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasojnë dhe vlerësojnë ndryshimet dhe ngjashmëritë ndërmjet legjislacionit vendor, të drejtës komperative dhe rregullave ndërkombëtare në fushën e noterisë; - Kuptojnë dhe aplikojnë parimet e përgjegjësive kontraktore dhe jashtëkontraktore në zgjidhjen e çështjeve juridike; - Përvetësojnë teknikat e hartimit dhe analizës së kontratave, testamenteve dhe dokumenteve tjera noteriale, duke vlerësuar pasojat juridike të dispozitave juridike; - Zbatojnë njohuritë e fituara për të ofruar zgjidhje praktike në raste të ndryshme të së drejtës noteriale; - Përgatiten për sfidat profesionale, duke zhvilluar shkathtësi për interpretimin dhe zbatimin e normave juridike në fushën e noterisë. |
| <p>Rezultatet e pritura:</p> | <p>Pas përfundimit të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpjegoj dhe analizoj konceptet dhe parimet themelore të së drejtës noteriale; - Identifikoj dhe krahasoj burimet e noterisë; - Zbaton normat juridike për të zgjidhur çështje praktike në fushën e noterisë; - Analizon dallimet ndërmjet llojeve të dokumenteve noteriale, si dhe mënyren e përpilimit të tyre; - Përdorë qasjen krahasimore për të vlerësuar ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet legjislacionit vendor, të drejtës krahasuese dhe instrumenteve ndërkombëtare në fushën e noterisë; - Harton dhe interpreton dokumente noteriale duke vlerësuar pasojat juridike të dispozitave kontraktore, pronësore, familjare, tarshëgimore, etj; - Zhvillon aftësi analitike dhe kritike në shqyrtimin e rasteve praktike dhe jurisprudencës relevante; - Vlerëson dhe aplikon mekanizmat e mbrojtjes juridike, përfshirë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes negociatave, ndërmjetësimit dhe procedurave tjerave gjyqësore. |
| <p>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të</p> | |

| nxënit të studentit) | | | |
|--|------------|------------------|--------------|
| Aktiviteti | Orë | Ditë/Javë | Total |
| Ligjeratë | 3 | 1/15 | 45 |
| Kontakti me mësimdhënësin (konsultimet) | 1 | 1/10 | 10 |
| Vizita studimore | 3 | 2/2 | 6 |
| Kollokviume | 3 | 2/2 | 6 |
| Detyrë shtëpie, zgjidhje e rasteve, prezantime, etj. | 1 | 15/15 | 8 |
| Totali | 3 ECTS | Totali | 75 |

| | |
|-------------------------------------|--|
| Metodologjia e mësimdhënies: | <p>Lënda do të zhvillohet përmes një kombinimi të metodave të ndryshme mësimore, të cilat synojnë të sigurojnë një përvetësim të thelluar të njohurive dhe zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike të studentëve. Metodologjia përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ligjëratat interaktive (Prezantimi i koncepteve kryesore dhe parimeve të së drejtës së detyrimeve përmes shpjegimeve teorike dhe ilustrimeve praktike); - Diskutimet në klasë – Nxitja e analizës kritike dhe debatit mbi çështje të ndryshme juridike, me fokus në problematika reale dhe sfida praktike; - Studimi i rasteve (Analizimi i vendimeve gjyqësore dhe çështjeve të rëndësishme juridike për të kuptuar zbatimin e normave ligjore në praktikë); - Puna në grupe (Bashkëpunimi i studentëve për të zgjidhur detyra dhe ushtrime praktike, duke zhvilluar aftësi për punën ekipore dhe argumentimin ligjor); - Ushtrime praktike (Simulime të rasteve gjyqësore dhe hartimi i kontratave për të përmirësuar aftësitë e analizës dhe interpretimit ligjor); - Kërkimi dhe analiza juridike (Angazhimi i studentëve në hulumtime mbi tema të caktuara për t'i aftësuar ata në përdorimin e burimeve ligjore dhe doktrimore); - Prezantime studentore (Paraqitja e temave të veçanta nga studentët për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe argumentimit juridik). |
| Metodat e vlerësimit: | <p>Për vlerësimin e studentëve, mësimdhënësi do të ketë në konsideratë (imperative) këto kritere.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi i vazhdueshëm:</u></p> <p>Pikët në dispozicion:</p> |

| | |
|-----------------------------------|---|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Zgjidhja e rasteve dhe angazhimet tjera në klasë dhe në shtëpi 20 pikë; - Testi i parë 40 pikë; - Testi i dytë 40 pikë. <p>Studentët që arrijnë rezultat pozitiv përmes vlerësimit të vazhdueshëm lirohen nga provimi. Vlerësimi i vazhdueshëm përfundon në muajin Maj 2025.</p> <p>Nota e fituar me anë të vlerësimit të vazhdueshëm ruhet deri në afatin e Shtatorit 2025. Me rastin e hyrjes në provim humb nota e fituar me anë të vlerësimit të vazhdueshëm.</p> <p style="text-align: center;"><u>Vlerësimi në provimin final:</u></p> <p>Studentët që nuk arrijnë sukses përmes vlerësimit të vazhdueshëm hyjnë në provimin final. Provimi final ka gjithsej 80 pikë, kurse 20 pikët e cekura më lartë (zgjidhja e rasteve dhe angazhimet tjera) numërohen dhe transferohen në provimin final.</p> |
| Notimi | <ul style="list-style-type: none"> - Deri në 50 pikë = Nota 5 (pesë); - Mbi 50 pikë = Nota 6 (gjashtë). - Mbi 60 pikë = Nota 7 (shtatë); - Mbi 70 pikë = Nota 8 (tetë); - Mbi 80 pikë = Nota 9 (nëntë); - Mbi 90 pikë = Nota 10 (dhjetë). |
| Literatura | |
| Literatura bazë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Bashkim Preteni/Aliriza Beshi, Shpend Haskaj/ Komentari i Ligjit për Noterinë (Prishtinë, 2025); 2. Hamdi Podvorica, E drejta noteriale (Prishtinë, 2020). |
| Literatura shtesë: | <ol style="list-style-type: none"> 1. Ligji për Noterinë në Kosovë; 2. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve; 3. Ligji për Familjen; 4. Ligji për Trashëgiminë; 5. Ligji për Proedurën Jokontestimore. |
| Plani i dizajnuar i mësim: | |
| Java | Ligjerata që do të zhvillohet |
| <i>Java e parë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Prezantim dhe diskutim mbi syllabusin; - Hyrje në të drejtën noteriale dhe veprimtarinë noteriale; - E drejta noteriale në sisteme të ndryshme juridike; - Raporti i të drejtës noteriale me degët tjera të së drejtës; - Parimet e të drejtës noteriale. |
| <i>Java e dytë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi mbi autorizimet e noterit; - Kompetenca lëndore e noterit; - Kompetenca territoriale e noterit; - Roli i noterit në transaksionet ndërkuftare. |

| | |
|-------------------------------|---|
| <i>Java e tretë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Karakteristikat e profesionit të noterit; - Noteri si i besuar nga shteti për ofrimin e shërbimeve publike; - Përgjegjësia disiplinore e noterit; - Përgjegjësia penale e noterit; - Përgjegjësia për shpërbilimin e dëmit; - Sigurimi i përgjegjësive profesionale të noterit. |
| <i>Java e katërt:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i dokumenteve noteriale; - Ndarja e dokumenteve noteriale; - Karakteristikat e dokumenteve noteriale; - Përpilimi dhe përmbajtja e dokumenteve noteriale; - Gjuha dhe procedura e përpilimit të dokumenteve noteriale; - Pavlefshmëria e dokumenteve noteriale. |
| <i>Java e pestë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi mbi aktin notarial; - Përmbajtja dhe procedura e hartimit të aktit notarial; - Ilustrim i disa kontratave noteriale; - Ilustrim i disa akteve tjera noteriale (prokura noteriale, pëlqime noteriale, deklarata noteriale, etj). |
| <i>Java e gjashtë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Vizitë studimore e të gjithë studentëve në një zyre noteriale; - Zyra noteriale do të përzgjedhet në koordinim me Odën e Noterëve; - Studentët shohin për së afërmi procedurën dhe përmbajtjen e përpilimit të dokumenteve noteriale. |
| <i>Java e shtatë:</i> | <p style="text-align: center;"><u>Testimi i parë i studentëve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Testimi i parë i ka gjithsej 40 pikë; - Për të marrur pjesë në testimin e parë është e domosdoshme pjesëmarrja në së paku 5 ligjërata; - Në testimin e parë lejohet përdorimi i ligjeve në formë fizike (të printuar). Nuk lejohet përdorimi i materialeve tjera shkencore; - Studenti duhet të arrijë së paku 21 pikë për tu konsideruar se ka arritur vlerësim pozitiv dhe të hynë në testimin e dytë. |
| <i>Java e tetë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Në përgjithësi mbi aktin notarial trashëgimor; - Përmbajtja dhe procedura e hartimit të aktit notarial trashëgimor; - Ilustrim i disa testamenteve noteriale dhe aktvendimeve noteriale; - Prezantim i praktikës noteriale trashëgimore nga ana e një noteri. |
| <i>Java e nëntë:</i> | <ul style="list-style-type: none"> - Vërtetimet noteriale dhe dokumentet tjera noteriale për ruajtjen dhe depozitimin e sendeve dhe parave; - Rregullat për hartimin, përmbajtjen dhe ruajtjen e dokumenteve noteriale lidhur me vërtetimet dhe depozitimin e sendeve dhe të parave; - Ilustrim i disa dokumenteve noteriale lidhur me vërtetimet noteriale dhe depozitimin e sendeve dhe të |

| | |
|------------------------------|--|
| | parave. |
| Java e dhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Njohja dhe zbatimi i dokumenteve noteriale vendore dhe të huaja; - Përmbartimi i dokumenteve noteriale vendore dhe të huaja; |
| Java e njëmbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Diketim dhe adresim i rasteve studimore. - Profesori përgatit rastin studimor; - Studentët ndahen në grupe dhe adresojnë zgjidhjen e rasteve. |
| Java e dymbëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Diketim dhe adresim i rasteve studimore. - Profesori përgatit rastin studimor; - Studentët ndahen në grupe dhe adresojnë zgjidhjen e rasteve. |
| Java e trembëdhjetë: | <ul style="list-style-type: none"> - Vizitë studimore e të gjithë studentëve në Odë të Noterëve; - Studentët do të shohin funksionimin e Odës së Noterëve dhe ushtrimin e mbikëqyrjes së noterëve përmes organeve të Odës së Noterëve; - Data e vizitës (brenda javës së trembëdhjetë) do të caktohet në koordinim me Odën e Noterëve. |
| Java e katërbëdhjetë: | - Simulim nga studentët i një seance noteriale. |
| Java e pesëmbëdhjetë: | <p style="text-align: center;"><u>Testimi i dytë i studentëve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Testimi i dytë i ka gjithsej 40 pikë; - Për të marrur pjesë në testimin e dytë është e domosdoshme pjesëmarrja në së paku 5 ligjërata pas mbajtjes së vlerësimit të parë; - Vetëm studentët që kanë arritur vlerësim pozitiv në testimin e parë (21 pikë) mund të marrin pjesë në testimin e dytë; - Në testimin e dytë lejohet përdorimi i ligjeve në formë fizike (të printuar). Nuk lejohet përdorimi i materialeve tjera shkencore. |

| |
|--|
| Konsultimet |
| <ul style="list-style-type: none"> - Konsultimet mbahen secilen javë (e marte dhe e enjte); - Secili student mund të kërkon takim virtual apo në fakultet për konsultime lidhur me lëndën duke i shkruar email profesorit të lëndës; - Profesori cakton orarin e konsultimeve sipas radhës së paraqitjes së kërkesave të studentëve. |
| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: |
| <p>Studenti gjatë pjesëmarrjes në ligjërata, testime dhe provime duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të respekton kodin e veshjes; - Të komunikon me respekt dhe mirësjellje me profesorin dhe studentët tjerë; - Të mos përdorë telefonin dhe paisjet tjera teknologjike; - Të respekton udhëzimet akademike; - Të mos kryej regjistrime të paautorizuara; - Të mos përdorë forma dhe mënyra tjera të papërshtatshme gjatë testimit të njohurive. |